

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021*

**20.03.2021
Ora 18:42**

RENDI I DITËS

**Projektakti "Pranimi për shqyrtim i kërkesës Ankimore nr. 05 me objekt
"Kundërshtimin e vendimit nr.156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror
të Zgjedhjeve" me ankues, subjekti Koalicioni PD - AN".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD

Z. E. Lako: Mirëmbrema, çelim sot seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementëve, të formës dhe të përmbajtjes së ankimit nr.5, dt.19.03.2021 të subjektit ankues Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.156, dt.17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur dje në dt.19.03.2021, bazuar në përcaktimet e nenit 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Kësaj rradhe një nga anëtarët e KAS-it, zoti Rusmali, do të marrë pjesë në seancë në distancë, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, në përputhje me përcaktimet e rregullores për funksionimin e KAS-it. Është i pranishëm gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu është i pranishëm në seancë edhe përfaqësuesi i Koalicionit PD-AN,

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021**

zoti Ivi Kaso, përshëndetje! Përpara se të fillojmë, ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së për të bërë një paraqitje të shkurtër të rrethanave të çështjes duke pas parasysh që seanca e sotme ka të bëjë vetëm me verifikimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së ankimit, faleminderit!

Z. Y. Merka: Koalicioni PD – AN është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të dt.25.04.2021 dhe ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën dhe dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore në dt.8.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listave shumemërore dhe brenda afatit ligjor PD-AN ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Në bazë të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë të Koalicionit PD – AN dhe ka konstatuar që listat shumemërore për zonat zgjedhore në vijim ka më shumë kandidatë se numëri i përcaktuar i kandidatëve në atë zonë zgjedhore. Përkatësisht:

- Zona Zgjedhor Qarku Elbasan ka gjashtë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Dibër ka tre kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Fier ka gjashtë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Berat ka tre kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Durrës ka gjashtë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Korçë ka nëntë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Kukës ka gjashtë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Lezhë ka tre kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Shkodër ka nëntë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Tiranë ka nëntë kandidatë më tepër;
- Zona Zgjedhore Qarku Vlorë ka gjashtë kandidatë më tepër;

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021**

Zona Zgjedhore Qarku Gjirokastrë ka tre kandidatë më tepër;

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e listave shumemërore të Koalicionit PD – AN për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021 sipas lidhjes bashkëlidhur, duke filluar nga: Zona Zgjedhore Qarku Berat për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.9;

Zona Zgjedhore Qarku Dibër për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.6;

Zona Zgjedhore Qarku Durrës për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.15;

Zona Zgjedhore Qarku Elbasan për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.15;

Zona Zgjedhore Qarku Fier për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.18;

Zona Zgjedhore Qarku Gjirokastrë për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.6;

Zona Zgjedhore Qarku Korçë për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.12;

Zona Zgjedhore Qarku Kukës për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.3;

Zona Zgjedhore Qarku Lezhë për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.9;

Zona Zgjedhore Qarku Shkodër për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.12;

Zona Zgjedhore Qarku Tiranë për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.36;

Zona Zgjedhore Qarku Vlorë për kandidatët e renditur nga nr.1 – nr.12.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Koalicioni PD – AN, në datën 19.03.2021, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.156, dt.17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, duke pretenduar se dispozita parashikon numër minimal kandidatësh që duhet të përmbajë lista shumemërore, por në asnjë rast, në asnjë rresht të dispozitës nuk përmbahet ndonjë parashikim lidhur me numërin maksimal të kandidatëve që duhet të përmbajë lista. Gjithashtu kërkon shfuqizimin e vendimit për pjesën që disponon për tejkalimin e numërit të lejuar të kandidatëve në listën shumemërore të Koalicionit PD – AN dhe kërkon miratimin e listave shumemërore ashtu siç janë paraqitur nga subjekti zgjedhor. Në datën 19.03.2021 është hedhur shorti dhe relator është zoti Elvin Lako, faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021**

Z. E. Lako: Faleminderit, nga shqyrtimi që i ka bërë administrata rezultojnë të plotësuar elementët e formës dhe të përmbajtjes së ankimit?

Z. Y. Merkaj: Neni 130 i Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e KQZ-së, legjitimin e ankuesit si dhe respektimin e afateve ligjore. Nga një vështrim që i kemi bërë dokumentacionit të paraqitur nga Koalicioni PD – AN, KQZ-ja ka kompetencën për shqyrtimin e ankimit. Gjithashtu legjitimimi i ankuesit pasi i janë prekur interesat legjitime të subjektit zgjedhor dhe respektimi i afateve që është bërë brenda tre ditë të përcaktuara në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. E. Lako: Faleminderit, nqs ankuesi dëshiron mund të thotë dy fjalë për elementët e formës dhe përmbajtjes.

Z.I.Kaso, përfaqësues i Koalicionit PD-AN: Faleminderit i nderuar, për sa i përket fabulës dhe asaj çfarë relatoi administrata nuk kemi shumë për të shtuar. Vlerësojmë që ashtu siç ka gjetur dhe administrata në verifikimin prima faccia, edhe nga ana jonë vlerësohet se janë respektuar elementët e formës dhe të përmbajtjes së ankimit. Është një ankim i cili prek drejtë për së drejti të drejtën dhe tagrin që ka ushtruar subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike –Aleanca për Ndryshim për paraqitjen e listave shumemërore duke i cënuar ato në këndvështrimin tonë. Pra, provohet më së miri interesi ynë i ligjshëm për të investuar KAS-in, i cili është organi kompetent për zgjidhjen e kësaj mosmarëveshje zgjedhore. Vlerësojmë gjithashtu se është operuar duke depozituar ankimin brenda afatit të parashikuar nga ligji, prandaj kërkojmë shqyrtimin në

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.20.03.2021

themel të këtij ankimi nga ana juaj. Një gjë të fundit që doja të shtoja, në rradhë të parë duke falenderuar që mbledhja juaj ishte ditën e sotme, pavarësisht parashikimeve qoftë të Kodit të Procedurës Civile, qoftë Kodit të Procedurave Administrative, që ditët e pushimit edhe ditët e festave kur përfundimi i afatit, qoftë për shqyrtimin paraprak, qoftë për shqyrtimin në themel, ky afat pezullohet. Doja t'u kërkoja formalisht që pavarësisht se neni 131, paragrafi i dytë i Kodit Zgjedhor e le në diskrecionin tuaj vendosjen e..., në rast se ju do të miratoni sigurisht shqyrtimin në themel të kësaj mosmarrëveshje zgjedhore. Pra, lihet në diskrecionin tuaj përcaktimi i seancës tjetër me një afat jo më të hershëm se 24 orë nga momenti i shqyrtimit paraprak dhe jo më të vonë se 48 orë. Duke konsideruar rëndësinë e çështjes, interesat e prekura dhe pritshmëritë legjitime jo vetëm të një subjekti zgjedhor, por dhe të një sërë kandidatësh individualë të cilët duan sa më shpejt qartësi për të kuptuar nëqoftëse do të përfshihen në listat shumemërore, ose jo? Por, mbi të gjitha dhe interesa që lidhen me organizimin dhe efikasitetin e KQZ-së për të organizuar një proces sa më normal votimi për zgjedhjet e datës 25 Prill. Duke marrë në konsideratë faktin që kjo vendimmarrje afekton në mënyrë të drejtë për drejtë vendimmarrjet e më pasme zinxhir siç janë ato të miratimit të fletës së votimit dhe të përmbajtjes së tyre dhe rrjedhimisht dërgimin e tyre për printim dhe përgatitjen fizike të tyre, do të kërkoja që kjo mosmarrëveshje të shqyrtohej në një afat sa më të afërt të mundshëm, qoftë kjo dhe brenda ditëve të pushimit siç keni vendosur të bëni shqyrtimin paraprak ditën e sotme. Kështu që në këtë kontekst do të ndalej dhe kërkesa ime duke ju bërë thirrje që pavarësisht se është në tagrin tuaj që të vendosni një moment tjetër nga ai që përcakton dispozita, që e përcakton me orë, përsëri të mbani në konsideratë këtë sensitivitet, që sikundër për ne është maksimal, besoj që për ju si KQZ do të jetë akoma më impenjativ se sa për ne, faleminderit!

Zbardhi materialin audio

Jona DERVISHI



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021**

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Kaso, në vijim të kësaj që thatë ju, ndaj dhe ne jemi mbledhur sot në ditë pushimi, për të pas një vendimmarrje sa më të shpejtë për një proces kaq të rëndësishëm siç është përgatitja e fletës së votimit. Kur të kemi vendimmarrjen, patjetër do të kemi parasysh dhe kërkesën tuaj. Anëtarët e komisionit kanë ndonjë pyetje për ankuesin, apo ndonjë sqarim, shpjegim?

Z. K. Bele: Kisha një pyetje për administratën. Duke qenë se nuk kemi këtu para, të paktën unë jo, procesverbalin e seancës. Nuk e di ka pas palë të tjera gjatë shqyrtimit nga Komisioneri, përveç ankuesit dhe ju si administratë?

Z. Y. Merkaj: Po ka pas dhe palë të tjera. Ka qenë dhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste, i cili ka dhënë dhe mendimin e tij. Mendojmë që, në qoftë se do të kalojë në seancë shqyrtimi, do ta njoftojmë si palë të interesuar dhe atë.

Z. K. Bele: Dakord, këtë kisha merak, për anën proceduriale, faleminderit!

Z. E. Lako: Zoti Rusmali, na dëgjon?

Z. I. Rusmali: Me vështirësi, por besoj se kam dëgjuar pjesën më të madhe të gjërave. Nuk di nëse më dëgjoni ju?

Z. E. Lako: Po ju dëgjojmë, jemi tek pjesa e pyetjeve, keni ndonjë pyetje, apo koment në këtë moment?

Z. I. Rusmali: Jo, nuk kam asnjë pyetje.

**Zbardhi materialin audio
Jana DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2021*

Z. E. Lako: Faleminderit! Atëherë, besoj se përfunduar me pjesën e pyetjeve dhe komenteve që kanë palët, administrata dhe ne. Në këtë moment KAS do të tërhiqet për vendim. Besoj se do ta marrim shumë shpejt vendimin, ju lutem jemi diku tek 10 minuta dhe do t'u njoftojmë menjëherë për të qenë këtu në seancë, ju faleminderit!

Rifillon mbledhja e KAS

Ora 18:55

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi në mënyrë unanime zhvillimin e seancës së shqyrtimit të kërkesës ankimore nr.5 me subjekt ankues Koalicionin PD-AN, ditën e martë me datë 23.03.2021, ora 10:00. Seanca mbyllet.

Vendimi nr.8

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

